

Qendra Kulturore Islame Shqiptare Sh.R.
Islamisch Albanisches Kulturzentrum e.V.

Mindener Str. 109 40227 Düsseldorf

Telefon +49 211 78 44 73



33 Kushtet e Fesë Islame

1. Pesë kushtet e Islamit janë:

- Shqiptimi i Shehadeti,
- Falja e Namazit,
- Agjërimi i Ramazanit,
- Dhënia e Zekatit,
- Shkuarja në Haxh (sipas mundësisë).

2. Gjashtë kushtet e Imanit janë:

- Besimin në Allahun,
- Besimi në Melaiket,
- Besimi në Librat e Allahut,
- Besimi në profetët e Allahut,
- Besimi në Ditën e Gjykimit,
- Besimi në vendimin dhe caktimin e Allahut.

3. Katër kushtet e Abdesit janë:

- Larja e fytyrës,
- Larja e duarve dhe krahëve deri në bryl,
- Larja e Kokës (mest),
- Larja e këmbëve deri në nyje.

4. Tre kushtet e Gusullit janë:

- Larja e gojës,
- Larja e hundës,
- Larja e të gjithë trupit.

5. Tre kushtet e Tejmumit janë:

- Bërja e nijetit,
- Prekja e dheut të pastër me të dy duart dhe fërkimi i fytyrës.
- Prekja e dheut të pastër me të dy duart dhe me dorë të majtë fërkojmë doren e djatht deri në bryl dhe anasjelltas.

6. Dymbëdhjetë kushtet e Namazit janë:

- Gjashtë para fillimit të Namazit janë:
 - ~ marja e Abdesit,
 - ~ të jetë i pastërt trupi, rrobat dhe vendi ku do të falemi,
 - ~ mbulimi e pjesëve të turpshme të trupit,
 - ~ drejtimi kah Kibla,
 - ~ kryerja e Namazit në kohën e vet të caktuar,
 - ~ vendosja e qëllimit(nijetit) me zemër.
- Gjashtë kushtet gjatë kryerjes së Namazit janë:
 - ~ tekbiri fillestar,
 - ~ qëndrimi në këmbë,
 - ~ këndim i Kur'anit,
 - ~ rënia në Ruku,
 - ~ rënia ne Sexhde,
 - ~ qëndrimi ulur në fund të Namazit.